



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Transaksioni i përfimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së 100% të kapitalit të Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëria Messer Technogas s.r.o dhe shoqëria Messer Tatragas, spol.s.r.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit, mbi shoqëritë Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëria Messer Technogas s.r.o dhe shoqëria Messer Tatragas, spol.s.r..

Palët në transaksion janë:

Blerësi 1: Messer Technogas s.r.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Çekisë.

Blerësi 2: Messer Tatragas, spol.s.r.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Sllovakisë.

Messer Group GmbH, është një shoqëri gjermane, shoqëria mëmë e Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.o.

Shoqëria Messer Group është e pranishme në Shqipëri përmes shoqërisë së kontrolluar Messer Albagaz SHPK.

Shitësi: Air Liquide Eastern Europe S.A është një shoqëri anonime e krijuar sipas legjislacionit francez.

Target 1: Air Liquide CZ, s.r.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Çekisë, me objekt veprimtarie; prodhimi i kimikateve të rrezikshëm dhe përzierjeve kimike të rrezikshme, shitja e kimikateve dhe përzierjeve kimike, të klasifikuara si shumë toksike dhe toksike, instalimi, riparimi, inspektimi dhe testimi i pajisjeve të gazit dhe mbushja e konteniervë me gaz, etj.

Target 2: Air Liquide Slovakia, s.r.o është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Sllovakisë. Objekti i veprimtarisë është; blerja dhe shitja e aparateve dhe pajisjeve të gazit industrial, blerja e mallrave për rishitje në fushën e tregtisë së lirë, prodhimi kimikateve bazë, prodhimi i gazrave industriale-gazrat teknikë/ përvrç prodhimit të

gazrave të ngrohjes, riparime, inspektime, dhe ekzaminime të pajisjeve të dedikuara gazrave teknikë dhe presionit teknik, etj.

Shoqëria Air Liquide Eastern Europe S.A, apo shoqëritë e kontrolluara prej saj nuk zotërojnë degë apo filial në Shqipëri dhe nuk realizojnë të ardhura në vend.

Palët kanë rënë dakort që Messer Tatragas, spol.s.r.o (Sllovakia) do të marrë 100% të kapitalit të regjistruar të Air Liquide Slovakia, s.r.o dhe Messer Technogas s.r.o (Republika Çeke) do të marrë 100% të kapitalit të regjistruar të Air Liquide CZ, s.r.o.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Diana Dervishi